

## **NË GJKATËN THEMELORE TË PRIZRENIT**

**Numri i lëndës: P. 233/2013**

**30 Tetor 2013**

Aktgjykimi i publikuar mund të mos jetë i formës së prere dhe mund të jetë objekt i ankesës në baze të ligjit të aplikueshëm.

### ***NË EMËR TË POPULLIT***

Gjykata themelore e Prizrenit, në trupin gjykues të përberë nga gjyqtari I EULEX-it Malcolm Simmons, si kryetar I trupit gjykues, dhe gjyqtari Zejnullah Gashi dhe gjyqtari i EULEX-it Manuel Soares, si anëtar të trupit gjykues dhe Valentina Gashi si procesmbajtëse në lenden penale kundër:

**A.B.**, i njohur gjithashtu si A.M., D.B., B.H dhe ‘T’; lindur B.H.<sup>1 2</sup> më xxx, në xxx, Qarkut i Drenasit, Kosovë, mashkull, numri i letërnjoftimit xxx, emri i babait M.H, emri i nënës K.C., shqiptar i Kosovës, shtetas i Kosovës, me banim në xxx, Qarku i Drenasit, i martuar, ka xxx fëmijë, gjendja ekonomike mesatare, në paraburgim që më 17 prill 2012;

I akuzuar sipas aktakuzës së prokurorit Special të EULEX-it, PPS. nr. 50/2011 i datës 15 Prill 2013 dhe të ushtruar me 16 Prill 2013 sikurse e modifikuar me 30 Tetor 2013 në pikat vijuese:

#### **PIKA 1**

**KRIMI i ORGANIZUAR**, nën nenin 274, paragrafi 1, 2 dhe 3 të Kodit Penal të Kosovës, i ndëshkueshëm me gjobe deri në 500.000€ dhe me burgim prej 7 deri në 20 vjet.

---

<sup>1</sup> changed his name to A.B.at the Kosovo Civil Registration Agency on 3 July 2009, number 201-3874

<sup>2</sup> E ndryshoi emrin e tij në A.B.në Zyrën e Gjendjes Civile më 3 korrik 2009, numër 201-3874.

**SEPSE** ndërmjet 5 shkurtit 2012 dhe 17 prillit 2012, **A.B** ne territorin e Kosovës, Malit te Zi, Kroacisë, Sllovenisë dhe Italisë ka kryer veprën penale te kimit te organizuar duke:

1. Organizuar, mbikëqyrur, menaxhuar apo drejtuar aktivitetet e një grupi te organizuar kriminel i përberë nga O.K., C.K., E.K., L.K., 'N.', A.B., A.C., N.N., M.B., A.M., I.H., M.H.("B"), T.H., Sh.B., N.P., Z.G., M.C., Z.M., G.N. dhe kryerësit te tjerë te pidentifikuar;
2. Duke kryer krime te renda, domethënë kontrabandimi i emigrantëve si pjese e një grupi te organizuar i përberë nga O.K., C.K., E.K., L.K., 'N.', A.B., A.C., N.N., M.B., A.M., I.H., M.H.("B"), T.H., Sh.B., N.P., Z.G., M.C., Z.M., G.N. dhe kryerësit te tjerë te pidentifikuar dhe/ose
3. Aktivisht duke marre pjese ne aktivitete te tjera apo kriminele te grupit te cekur te organizuar kriminel duke ditur se pjesëmarrja e tyre do te kontribuonte e kryerje te krimeve te cekura te renda nga grupi; me qellim qe te përfitojnë drejtpërsëdrejti apo tërthorazi benficione financiare apo përfitime te tjera.

## **PIKA 2**

**KONTRABANDIMI I MIGRANTEVE**, nen nenin 138 (1) te Kodit Penal te Kosovës,

**SEPSE**, me 3 shkurt 2012 dhe 17 prill 2012, A.B., ne territorin e Kosovës, Malit te Zi, Kroacisë, Sllovenisë dhe Italisë ka kryer veprën penale te kontrabandimit te migrianteve duke u përshirë ne kontrabandim te personave te cilët nuk janë banor vendor apo te përherhëm te shtetit qe te kalojnë kufirin duke mos u bindur me kërkesat për hyrje ligjore, për emigrantet vijues:

- (1) Ndërmjet 5 shkurtit 2012 dhe 25 shkurtit 2012, duke kontrabanduar Z.G., shtetas Turk, A.G., shtetas Turk, M.G, shtetas Turk, R.G shtetas Turk, B.G,, shtetas Turk dhe G.K shtetas Turk nga Kroacia nëpërmjet Sllovenisë ne Itali.
- (2) Ndërmjet 26 shkurtit 2012 dhe 10 Marsit 2012, duke kontrabanduar H.K., shtetas Turk dhe G.K, shtetas Kosovar nga Kroacia, nëpërmjet Sllovenisë ne Itali.
- (3) Ndërmjet 24 shkurtit 2012 dhe 16 Marsit 2012, duke kontrabanduar A.B.1, shtetas i Kosovës, M.H., shtetas i Kosovës, R.J.,,, shtetas i Kosovës dhe A.K., shtetas i Kosovës, nga Kosova neper Mal te Zi dhe Kroaci ne Slloveni deri ne Itali si destinacion i menduar.
- (4) Ndërmjet 17 marsit 2012 dhe 28 Marsit 2012 duke kontrabanduar Burim (mbiemri i panjohur), dhe dy emigrant te tjerë nga Kosova neper Mal te Zi dhe Kroaci ne Slloveni deri ne Itali si destinacion i menduar.

Në bashkëkryerje nen nenin 23 të Kodit Penal të Kosovës.

**PAS MBAJTJS** se shqyrtimit kryesor ne seance te hapur me 28 dhe 30 tetor 2013, ne prani te të akuzuarit A.B.,,, avokati i tij mbrojtës H.K, dhe ne prani te Prokurorit Special te EULEX-it Alister Cumming te Zyrës se prokurorisë speciale te Kosovës dhe pas këshillim – votimit te mbajtur me 30 tetor 2013,

**NË PAJTIM** me nenin 359 te Kodit<sup>3</sup> te Procedurës Penale ( ne tekstin vijues KPP) me 30 tetor 2013, ne seance te hapur dhe ne prani te të akuzuarit, avokatit te tij mbrojtës dhe Prokurorit Special te EULEX-it, gjykata nxjerr dhe shpall si ne vijim:

---

<sup>3</sup> Kodi Penal numër 04/ L-123

---

## AKTGJYKIM

---

**A.B.**, me shënimet personale te lartcekura, në paraburgim qe nga 17 Prilli 2012 shpallet si ne vijim:

Në pajtim me nenin 363, paragrafi 1 (1.1) te KPP-se.

Pika 1:           **REFUZOHET** sepse prokurori i ka tërhequr akuzat gjate shqyrtimit kryesor;

Në vazhdim, në pajtim me nenin 365 te KPP-se,

Pika 2:           **FAJTOR**, për kontrabandim te migranteve nen nenin 138, paragrafi 1 i Kodit Penal te Kosovës (në tekstin vijues 'KPK'), ne bashkëkryerje nen nenin 23 te KPK-se.

**SEPSE** i akuzuari, A.B.,,, është përfshirë ne kontrabandim te emigrantëve, kryesisht me origjine Turke, nga Kosova ne Kroaci dhe Slloveni dhe me tej ne destinacionin e tyre te kërkuar ne Itali dhe shtete te tjera Evropiane, duke përfshirë Hungarinë, Austrinë, Gjermaninë dhe shtetet te tjera te Evropës Perëndimore, ne mënyrë specifike:

1. Ndërmjet 5 shkurtit 2012 dhe 25 shkurtit 2012, A.B.,, ka kontrabanduar një grup prej 6 migranteve Turk ilegalisht nga Kroacia ne Slloveni, ne Itali si destinacion i kërkuar. Këta migrant jane identifikuar si Z.G, i lindur me xxx, A.G.,,, i lindur me xxx, M.G i lindur me xxx, B.G i lindur me xxx dhe G.K i lindur me xxx.

Planifikimi i veprës penale ka filluar me 5 shkurt 2012, kur A.B ka hyre ne një marrëveshje me N, rekrutues dhe organizues kryesor ne nivel trans nacional, qe

rregullisht kontrabandën migrantet nëpërmjet Malit të Zi dhe Kroaci për në Slloveni dhe Itali. Pas kësaj marrëveshje, A.B. ka kontaktuar anëtar të tjerë të grupit kriminel nga 6 deri me 19 shkurt 2012 me qëllim që ata të përgatiten. Këta anëtar duke përfshirë Z.G.1 në Kroaci, Sh.B. në Itali, A. (mbiemri i tij i panjohur) në Kosovë, dhe një anëtar i paidentifikuar i grupit në Mal të Zi. A. do të punonte me A.B. në Kosovë që të koordinojnë shoferet dhe Z.G.1 do të kujdes për transportim të migrantëve në Kroaci në drejtim të Sllovenisë, gjersa Sh.B. do të mbikëqyrte kalimin e tyre të mëtejme në Itali dhe transportimin pas kësaj.

Planifikimi i operacionit me tej është konkretizuar më 21 shkurt 2012, kur A.B. ka hyrë në një marrëveshje të drejtpërdrejt me L.K, organizuese kryesore në nivel të lartë mbi N në grupin e njëjtë të organizuar kriminel, që të kontrabandojë grupin prej 6 njerëzve në ditët vijuese. Këta 6 migrant ishin shtetas Turq Z.G., A.G., M.G., B.G. dhe G.K.. L.K. e ka njoftuar A.B. që migrantet në përbërje të familjes prej 5 të rriturve dhe një fëmijë 7 vjeçar. Ai është pajtuar për kontrabandim të këtyre personave nga Zagrebi, Kroacia për në Itali. Anëtar të tjerë të grupit të gjere të organizuar kriminel tani më i kanë transportuar ata nga Turqia në Kroaci, ku A.B. do të merrte përsipër. Migrantëve iu janë kërkuar të hollat për secilin nga 1.400 € për transportim të tyre nga Kroacia nëpërmjet Sllovenisë vetëm për në Itali.

Gjersa L.K. ishte pika kontaktuese e drejtpërdrejt dhe kryesore për A.B.,, drejtimi i tërësishëm është dhënë nga burri i saj O.K, lider i grupit kriminel. Kjo është demonstruar nga Luljeta e cila ka kërkuar leje nga O. gjersa ishte duke folur në telefon me A.B. rreth operacionit që duhet të kryhet. A.B.,, po ashtu ka pranuar udhëzime drejtpërsëdrejti nga O.K. lidhur me kontrabandimin të këtij grupi të veçantë të migrantëve. Në veçanti O.K. ka hulumtuar rreth shofereve, kohën dhe modalitete të lëvizjes të migrantëve dhe hyrje në shtetin e destinacionit të planifikuar, dhe ku migrantet do të akomodoheshin në Rjekë dhe të hollat që do të merreshin nga ata në Kroaci. C.K.,, vëllai i O., po ashtu ishte i

përshirë ne marrëveshjet te kontrabandimit nga Turqia dhe ka komunikuar drejtpërsëdrejti me A.B...

Roli i A.B. ishte qe te komunikoj me transportuesit nga Kroacia ne Slloveni për ne Itali, fazat kryesore te udhëtimit te migraenteve duke ditur se këto ishin fazat qe krimi është konkretizuar me kalimin ilegal te kufijve ne shtetet e BE. Duke vepruar kështu A.B. ka biseduar me M.C.. M.C. i ka organizuar shoferet drejtpërsëdrejti, duke komunikuar përsëri me A.B., shpesh qe te merr udhëzime dhe te pajtohet lidhur me aranzhimet e te hollave. Në vazhdim, A.B., aranzhoi akomodimin e emigraenteve ne Opati, Kroaci ne “Hotel Opatija” hotel i cili është prone e G.N., anëtar tjetër i grupit ne Kroaci e cila po ashtu bashkëpunon me M.C..

Përveç kësaj, A.B. ishte përfshirë ne aktivitete ne Slloveni me bashkëpunëtorin e tij i njohur si R.L., i cili ka kontribuar ne kryerje te veprës penale si shofer për grupin nga Sllovenia për ne Itali.

Ne mbrëmje te 23 shkurtit 2012, migrantet jane nisur nga Zagrebi, Kroaci për ne Rjekë, Kroaci, ne dy grupe. Disa nga grupi shkuan me taksi për 350 € nga Zagrebi ne Rjeke, gjersa te tjerë kane shkuar me autobus pasi qe A.B. shprehu brengen e tij te L.K. duke i thënë se ata do te zihen nëse te gjithë shkojnë me taksi atë nate. Në Rjeke ata u takuan me shoferet te organizuar nga M.C., i cili i morri ata dhe i dërgoi ne “hotel Opatija” prone e G.N.... Migrantet jane shtyre për te paguar 200 € për qëndrim për 1 natë. Më 24 shkurt 2012, A.B ka biseduar për marrëveshjet finale me M.C. për transportim te migraenteve nga Rjeka, Kroaci për ne Slloveni dhe me tej për ne Itali. M.C dhe një bashkëpunëtor i tij kane udhëtuar ne Rjeke ne atë mbrëmje me qellim qe te jene te gatshëm qe ti transportojnë migrantet ne mëngjesin e ardhshëm.

Më 25 Shkurt 2012, rreth orës 05.00, M.C dhe një shofer tjetër i morën migrantet nga Hotel Opatija. Ne këtë moment migrantet jane shtyre qe ti japin edhe 1.200€ shofereve

( 500 € njërit dhe 700€ shoferit tjetër). Tre migrantet kane udhëtuar ne secilën prej dy makinave ne drejtim te kufirit Kroat me Slloveninë. Kufiri ne fakt është kaluar ne Starod, me migrantet duke hyre ne Slloveni ilegalisht diku ne ora 11.00.

Rreth orës 11.00 ne atë dite, migrantet jane takuar me një shofer tjetër ne makinën Mercedes ne Racice, regjionin e Ilirska Bistrica, Slloveni i cili është siguruar nga A.B. qe ti sjell ata ne Itali. Plani paraprak ishte qe ata te dërgohen ne Udine, Itali, mirëpo ne atë dite shoferi i dërgoi ne drejtim te Triestes Itali.

Z.G., A.G., M.G., B.G. dhe G.K., te gjithë jane ndalur ne pike kontrolli policor pasi qe ata ilegalisht kane kaluar ne Itali ndërmjet orës 11.00 dhe 13.00 dhe ku jane depërtuar për ne Slloveni ku ata jane arrestuar nga policia Sllovene ne regjionin Ilirska Bistrica.

Mosha dhe identiteti i migraenteve përputhet me rrethanat faktike te komunikuar ne thirrjet te përgjuara te A.B.,,, domethënë se migrantet ishin familja duke përfshirë edhe fëmijën. Veçanërisht, fëmija me i ri i grupit (B.G) ishte vetëm xxx vjet ne kohen e ngjarjeve, edhe me i ri se sa qe është treguar sikurse xxx vjeçar. Përveç kësaj 3 fëmijë te tjerë po ashtu jane kontrabanduar pasi qe R.G. ishte xxx, A.G, xxx dhe M.G. xxx ne atë kohe. Vetëm dy anëtar te grupit ishin te rriturit (Z.G, xxx dhe G.K, xxx).

2. Ndërmjet 26 shkurtit 2012 dhe 10 Marsit 2012, A.B. i ka kontrabanduar dy migrant ilegalisht nga Kroacia ne Slloveni, për ne Itali si destinacion i menduar. Këta migrant jane identifikuar si H.K shtetas turk i lindur me xxx (xxx vjeçar) dhe G.K shtetas Kosovar i lindur me xxx (xxx vjeçar).

Planifikimi i veprës penale ka filluar me 26 shkurt 2012, kur A.B. është pajtuar qe te kontrabandoj G.K. nga Kosova për ne Itali. Me tej me 27 shkurt 2012 A.B. ka arritur pajtim me vëllezërit K. qe ti transportojnë dy migrant Turq nga Zagrebi, Kroaci për ne Itali. Migrantet tani më jane transportuar nga Turqia ne Kroaci nga anëtar te tjerë trans

nacional te grupit te organizuar kriminel. Më 6 Mars 2012 O.K e ka thirr A.B. personalisht, ku është sqaruar se një migrant Turk do te duhet te transportohet. Ky migrant qe te kontrabandohet ishte H.K.. . Ne atë dite me vone, A.B. është pajtuar me L.K. se H. do te transportohet ne kohen e njëjtë sikurse edhe migranti nga Kosova.

Roli kryesor i A.B. ishte qe te komunikoj me transportuesit nga Kroacia ne Slloveni për ne Itali, fazat qe krimi është konkretizuar me kalimin ilegal te kufijve ne shtetet e BE. Duke vepruar kështu A.B. ka biseduar aktivitetet ne Kroaci me M.C i cili ka organizuar shoferet. A.B. po ashtu e aranzhoi me G.N., e cila siguroi akomodimin ne “Hotel Opatija” afër Rjekës, M. dhe G. po ashtu i raportonin Z.M., menaxher për grupin kriminel ne Kroaci.

Më tej, A.B. po ashtu ka bashkëpunuar me Sh.B, shtetas i Kosovës, T.H, shtetas i Kosovës dhe H.B, shtetas serb qe jeton ne Mal te Zi qe shërbyen si udhërrëfyes dhe transportues. Këta tre anëtar te grupit drejtpërsëdrejti i kane shoqëruar migrantet gjate këtij udhëtimit. Ata po ashtu ilegalisht e kane futur veten ne Slloveni.

Migranti është dërguar nga Rjeka, Kroaci ne Slloveni me 8 Mars 2012, duke kaluar kufirin ilegalisht ne regjionin e Ilirska Bistrica, Slloveni me barke ne rrethine te Koperit. Ata vazhduan udhëtimin e tyre ne drejtim te Italisë ne natën e 9 marsit 2012, me përpjekje qe ti shmangen policisë kufitare.

A.B. drejtpërsëdrejti ka komunikuar me migrantet gjate udhëtimit, duke i treguar atyre ne detaje te sakta se ku duhet te kalojnë kufirin ndërmjet Sllovenisë dhe Italisë. Nga këto komunikime, natyra e paligjshme e hyrjes është jashtëzakonisht e qarte. Për shembull, ai i ka udhëzuar migrantet qe te mos kërcejnë mbi rrethoja mirëpo te ecin përreth tyre neper binaret e trenit, pasi qe ekzistojnë rroje me qentë. Ai me tej i ka udhëzuar migrantet qe te ecin përmes pishave ne drejtim te Italisë, duke i treguar se ata do te hyjnë ne Itali nëpërmjet një pikë kalimi ilegal nëpërmjet pyllit.

Migrantet H.K., dhe G.K po ashtu edhe transportuesit Sh.B., H.B., T.H., qe te gjithë jane ndalua ne piken kontrolluese policore pasi qe ilegalisht kaluan kufirin për ne Itali ne orët e mëngjesit te 210 Marsit 2012. Ata jane depërtuar ne Slloveni ku jane arrestuar nga Policia Sllovene ne regjionin e Ilirska Bistrica.

Nga komunikimet e përgjuara pas ndodhjes se arrestit është zbuluar roli i Sh.B., H.B., T.H. si transportues për grupi kriminel. Ata jane dërguar dhe mbajtur ne një kamp për migrantet ilegal ne Kroaci se bashku me dy migrantet, pasi qe hyrje e tyre po ashtu ishte e paautorizuar. T.H. dhe G.K jane liruar dhe depërtuar ne Kosove me 15 mars 2012, gjersa Sh.B. është liruar dhe depërtuar me 16 mars 2012. Ne veçanti, natyra ilegale e aktiviteteve te tyre ne Kroaci është demonstruar nga sugjerimi i A.B. duke i treguar Sh.B. qe te thotë dhe te tregoj një shpjegim për prezencën e tyre ne Kroaci policisë kufitare ne Kosove gjate arritjes se tyre ne aeroportin e Prishtinës e ky shpjegim nuk ishte i vërtet.

Vëzhgimi Fotografik i A.B. nga Policia e EULEX-it me 12 Mars 2012 me tej vërteton dëshminë e përfshirjes se tij ne operacionet e kontrabandimit, pasi qe ai është fotografuar duke pritur ne aeroport te Prishtinës për G.K. dhe T.H. .

3. Ndërmjet 24 shkurtit 2012 dhe 16 Marsit 2012, A.B. ka kontrabanduar 4 migrant ilegalisht nga Kosova nëpërmjet Malit te Zi dhe Kroacisë për ne Slloveni deri ne Itali si destinacion i menduar. Këta migrant jane identifikuar si A.B.1.,, shtetas i Kosovës, i lindur me xxx (xxx vjeçar), M.H.,, shtetas i Kosovës, i lindur me xxx (xxx vjeçar), R.J, shtetas i Kosovës, i lindur me xxx (xxx vjeçar) dhe A.K shtetas i Kosovës, i lindur me xxx (xxx vjeçar).

Planifikimi i operacionit te kontrabandimit ka filluar me 24 shkurt 2012, kur A.B. ka pranuar thirrje nga “V” anëtar i grupit te tij ne Kosove, duke e njoftuar atë se 4 migrant ishin rekrutuar ( duke u referuar si “ katër makina” ne gjuhen e koduar) dhe ata ishin te

gatshëm që të transportohen nga Kosova për jashtë vendit. Mbi të gjitha A.B. ka raportuar të O.K. për operacionin. Secili migrant iu është kërkuar nga 2.500€ për transportim të tyre nga Kosova nëpërmjet Malit të Zi, Kroaci dhe Slloveni për të shkuar në Itali. Ata e lanë këtë shumë të I. (mbiemri i tij i panjohur) në Kosovë, si siguri, deri sa transportimi i tyre të kryhet, të dërgohen në Evropë.

Roli kryesor i A.B. ishte që të komunikoj me transportuesit nga Kroacia në Slloveni për në Itali, fazat që krimi është konkretizuar me kalimin ilegal të kufijve në shtetet e BE. Duke vepruar kështu A.B. ka biseduar aktivitetet në Kroaci me M.C i cili ka organizuar shoferet. A.B. po ashtu e aranzhoi me G.N.e cila siguroi akomodimin në "Hotel Opatija" afër Rjekës, M. dhe G. po ashtu i raportonin Z.M menaxher për grupin kriminel në Kroaci.

Më tej, A.B. po ashtu ka bashkëpunuar me M.H., shtetas i Kosovës, I.H. shtetas i Kosovës dhe H.B. shtetas serb që jeton në Mal të Zi, dhe R.R., shtetas Serb. I.H, H.B dhe R.R. shërbyen si udhërrëfyes dhe transportues nga Kosova për më tej gjersa M.H. u kujdes për aranzhimet në anën Italiane. I.H., H.B. dhe R.R. drejtpërsëdrejti i kanë shoqëruar migrantet gjatë këtij udhëtimit. Ata po ashtu ilegalisht e futën veten në Slloveni.

Përveç kësaj A.B. i ka diskutuar aktivitetet në Mal të Zi, shteti transit, me bashkëpunëtorin e tij të njohur si "C" i cili ka kontribuar në kryerje të veprës penale si shofer për grupin nga Mali i Zi për në Kroaci dhe Slloveni.

Migrantet janë nisur nga Kosova për në Mal të Zi më ose rreth 14 Marsit 2012. Migrantet dhe transportuesit kanë qëndruar me "C" në Mal të Zi. A.B. i tha "C" që të siguroj që secili migrant ti jep shoferit 300€ shtese dhe 700€ një bashkëpunëtori tjetër Malazez i cili menaxhonte transportimin. Në fakt bashkëpunëtori Malazez i ka marrë 1.000€ nga migrantet.

Nga Mali i Zi me 15 Mars 2012, migrantet jane vozitur nga dy anëtar malazez te grupit kriminel ne Kroaci ku jane akomoduar nga G.N. ne "Hotel Opatija" afër Rjekës. Ne një moment ata u ndërruan makinat për t'iu shmangur autoriteteve. Më pas me anë te anijes jane dërguar ne Dubrovnik, ne Kroaci. A.B. ishte ne kontakt me "C" dhe me anëtar te tjerë malazez te grupit kriminel përgjatë rrugës, duke i siguruar udhëzime te vazhdueshme se si duhet te udhëhiqet rruga, aranzhimet e te hollave, dhe akomodimi. Anija ka arritur rreth orës 09:40 minuta me 16 Mars 2012.

Nga atje migrantet jane dërguar ne drejtim te kalimit kufitar ne regjionin e Ilirska Bisticës, ne Slloveni. Një shoferit te ri iu është thënë nga A.B. qe te pres për migrantet ne anën tjetër te kufirit Kroato- Slloven. Migrantet kaluan kufirin ne këmbë ne natën e 16 Marsit 2012 dhe ne orët e hershme te datës 17 Mars 2012. A.B. ishte ne dijeni rreth planave për ata qe te shkojnë tutje qe te kalojnë kufirin nga Sllovenia për ne Itali ne drejtim te Gorizia, ne regjionin e Fruli Venzia Giulia ne Italinë veriore.

Megjithatë, te 4 migrantet, A.B., M.H., R.J., dhe A.K. po ashtu edhe transportuesit I.H., H.B., and R.R. ishin kapur nga Policia Sllovene ne Ilirska Bistrica dhe jane arrestuar.

4. Ndërmjet 17 Marsit 2012 dhe 28 Marsit 2012, A.B. ka kontrabanduar 3 migrantet ilegalisht nga Kosova nëpërmjet malit te Zi dhe Kroacisë për ne Slloveni, deri ne Itali si destinacion i parapare. Njeri prej migraenteve ishte identifikuar si B. (mbiemri i tij i panjohur), shtetas i Kosovës.

Planifikimi për këtë operacion te kontrabandimit ka filluar me 17 Mars 2012, kur A.B. ka aranzhuar me rekrutues qe te dërgoj grupin e ri jashtë vendit për një çmim prej 2.800€ për një migrant. Rekrutuesi e ka njoftuar A.B. se ai i ka kërkuar me shume migraenteve për 200€, mirëpo A.B. i tha atij se ai mund ti mbaj për vete.

Roli kryesor i A.B. ishte te komunikoj me transportuesit nga Kosova për ne Mal te Zi, Mali i Zi për ne Kroaci, Kroaci për ne Slloveni dhe tutje nga atje për ne Itali. Krimi është konkretizuar me kalimin ilegal te kufirit ndërmjet Kroacisë – Sllovenisë dhe hyrjes ne Slloveni dhe Itali pa autorizim.

Në kryerje te kontrabandimit te migraenteve A.B. ka diskutuar aktivitetet ne Mal te Zi me një bashkëpunëtor te cekur dhe ne Kroaci me M.C, secili prej tyre ka organizuar shoferet ne zonat e tyre te respektueshme. A.B. po ashti e ka angazhuar G.N.dhe motrën e saj, e cila ka siguruar akomodimin ne Hotel Opatija afër Rjekës, Kroaci. M., G. dhe motra e saj po ashtu i raportonin Z.M., i cili është menaxher i grupit kriminel ne Kroaci.

Në vazhdim, A.B. ka bashkëpunuar me I.H., dhe Sh.B. te cilët shërbyen si udhëheqës dhe transportues nga Kosova e tutje.

Më ose rreth orës 04.00 te datës 22 Mars 2013, 3 migrantet nga Kosova kane shkuar ne Mal te Zi. Ata arritën ne Budva, Mal te Zi rreth orës 11.00, ku jane takuar nga anëtari i grupit ne Mal te Zi ne stacionin e autobusit. Ata jane akomoduar për te kaluar natën nga një bashkëpunëtor tjetër Malazez. Ditën e ardhshme ata jane vozitur për ne Dubrovnik, Kroaci ku jane takuar nga transportuesi tjetër. A.B. i ka thënë bashkëpunëtorit te tij i njohur si “K H.” ne Mal te Zi te siguroj se secili prej migraenteve ti japin nga 300€ ne Budva dhe 100€ te tjera kur te arrijnë ne Dubrovnik. Grupi ka kaluar kufirin Kroato-Sllovene diku me 27 Mars. Pas kësaj ata duhej te udhëtoni tutje për ne Itali me shoferin tjetër. Megjithatë, migrantet ishin arrestuar nga Policia Sllovene dhe jane depërtuar ne Kosove.

**PRANDAJ**, nga arsyet e lartcekura gjykata shqipton dënimet si ne vijim:

Duke u gjetur fajtor nen piken/ akuzën 2 mbi kontrabandimin e migraenteve nen nenin 138 paragarfi1 te KPK-se i akuzuari dënohet me burgim ne kohëzgjatje prej tre (3) vitesh.

Në pajtim me nenin 73, paragrafi 1 i KPK-se koha e kryer ne paraburgim nga data 17 Prill 2012 deri ne datën e cekur këtu duhet te llogaritet ne kuadër te dënimit.

Në pajtim me nenin 451, 453 dhe 450 te KPP-se i akuzuari duhet ti paguaj shpenzimet e procedurës penale qe jane te caktuara ne shumen prej 100€.

Çfarëdo padi pronësore – juridike duhet të ndiqet nëpërmjet gjykatave civile.

Ky aktgjykim mund të shpallet në shtypin ditor dhe media publike.

---

**Gjyqtari Malcolm Simmons**  
**Kryetari i trupit gjykues**

---

**Gjyqtari Manuel Soares**  
**Anëtar i trupit gjykues**

---

**Gjyqtari Zejnullah Gashi**  
**Anëtar i trupit gjykues**

---

**Valentina Gashi**  
**Procesmbajtëse**